



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-351/02-98255

Dt. 26.08.2024

Prizren

DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR, me kërkesën e poseduesit **Kompania e Re Fabrika-Reqan LL.Shfrytëzuesi- Qirambajtje-99 vite - Pllanjan - Qiramarrje FRUTTI SH.P.K. – Reçan** në bazë të nenit 3alineja 1 pikat 1.7 , 1.17. dhe nenit 5 alineja 1 pika 1.1 neni 14 alineja 1. Pika 1.1 nenin 15 alineja 1 pika 1.1 , neni 18 e lidhur me dhe nenin 19. pika 2. të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110, si dhe nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr.04/L-174 të dt.31.07.2013 ,si dhe konform nenit 14,15,16,17,18 dhe 19 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2017 dt. 23.05.2017 , si dhe konform nenit 4 pika 6.1 ,paragrafi 2,dhe paragrafi 14 si dhe pika 6.3 e Rregullores për taksa,tarifa,ngarkesa dhe gjoba nga Shërbimet dhe Veprimtaritë Komunale nr.001/001-46063 dt. 28.03.2019 si dhe Vendimit për përcaktimin e taksës administrative për lëshimin e lejes ndërtimore dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës në territorin e qytetit të Prizrenit nr.01/011-41141 të dt.10.04.2014, nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 44,46,47,48 si dhe nenit 125 të L.P.P.A nr. 05/031 dt. 25.05.2016 merr këtë:

VENDIM
(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	poseduesi Kompania e Re Fabrika-Reqan LL.Shfrytëzuesi- Qirambajtje-99 vite - Pllanjan -Qiramarrje FRUTTI SH.P.K. – Reçan		
Adresa:	Në vendin e quajtur “ Reka “në rrugën Prizren - Pllanjan		
Telefoni:	/	Emaili:	

Emri i projektit	Objekti – afarist - depo
Emri i projektuesit	N.Sh.N. Byro Projektuese “ STRUKTURA “
Adresa:	“ Lidhja e Prizrenit “ – ndërtesa kati V - Ferizaj

Telefoni:	/	Emaili:	
-----------	---	---------	--

Me këtë Vendim , aplikuesit për leje ndërtimore si poseduesit Kompania e Re Fabrika-Reqan LL.Shfrytëzuesi- Qirambajtje-99 vite - Pllanjan -Qiramarrje FRUTTI SH.P.K. – Reçan i lejohet ndërtimi i objektit- **afarist – depo në vendin e quajtur “ Reka “në rrugën Prizren - Pllanjan** në ngastrën kadastra le P-71813066-02766-4 Zona Kadastra le Pllanjan .

	Për punët ndërtimore në vijim	
Adresa:	ZK Pllanjan	
Zonat (t) Kadastrale	Lokacioni i ndërtimit gjendet në Zonën Kadastrale Pllanjan Objekti – afarist - depo me etazhitet S+P do të ndërtohet në parcelën kadastrale nr.P-71813066-02766-4 Z.K.Pllanjan me sipërfaqe S=2121 m ² sipas kopjes së planit. sipërfaqe bruto e përdhese është S=1551.44m ² . sipërfaqe neto e përdhese është S=1493.64m ² .	GPS Koordinatat:

- Është miratuar taksa administrative për lëshimin e lejes ndertimore në shumën prej **6500.53€**
- Parallogaria e vlerës së objektit sipas këtij dokumentacioni teknik është në shumën prej **338,423.10 €**.

Lloji i ndërtimit të propozuar:	
Ndërtimi i ri ☒	Rindertim ☐ Ripatim ☐
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:	
Kategoria I ☐	Kategoria II ☒
A përfshin kërkesa ndryshimin e destinimit? Po ☐ Jo ☒	
Përdorimi i propozuar: objektit – afarizëm	

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore Kompania e Re Fabrika-Reqan LL.Shfrytëzuesi- Qirambajtje-99 vite - Pllanjan -Qiramarrje FRUTTI SH.P.K. – Reçan i lejohet ndërtimi i objektit –afarist - depo .

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore. Në rast se nuk fillohet me ndërtim brenda këtij afati atëherë mund të bëhet kërkesa për vazhdim të lejes ndërtimore brenda afatit të vlefshmërisë së lejes ndërtimore;
- Të vendosë tabelen informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejen Ndërtimore
 - Informatat mbi projektuesin
 - Informata mbi kontraktuesin
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
 - Të rrethoj vend ndërtimin (punishten)
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - Një kopje të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - Projektin kryesor me të gjitha faza për nevojat e realizimit të ndërtimit;
 - Dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - Librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore;
 - Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveq në rast kur:
 - Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;

- Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

A r s y e t i m

Kompania e Re Fabrika-Reçan LL.Shfrytëzuesi- Qirambajtje-99 vite - Pllanjan - Qiramarrje FRUTTI SH.P.K. – Reçan ka kërkuar nga organi kompetent **DUPH** lëshimin e lejes ndërmimore për **objektin – afarist – depo .**

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit , si dhe bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110, Ligjin Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.


Kjo Leje Ndërmimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Njoftim për plotësim të dokumentacionit
- Pëlqimi nga “KEDS-i”.
- Pëlqimi nga Kom.”Hidroregjioni Jugor”.
- Pëlqimi nga Telekom i Kosovës – PTK-ja.
- Pëlqimi nga “Ekoregjioni”.
- Vendim për kyqje nga MMPHI.
- Pëlqim nga Agjencioni Menaxhimit Emergjent.
- Vendim – Leja Mjedisore.
- Tri kopje të projektit kryesor.

Udhëzimi juridik: pala e pakënaqur me këtë aktvendim, përmes kësaj Drejtorie me ankesë mund t’i drejtohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, brenda afati prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi.

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Bashkëpunëtor profesional:



Afërdita Mormorina, inxhi. dip. ark.

DREJTORI



Pranverim Berisha , jur.

